



Thirrje për aplikim lidhur me pjesëmarrjen në:

“Shkolla për ndryshime klimatike dhe tranzicionin e energjisë”

Vendi: Hotel “Magra Austria” Bogë, Pejë

Koha e mbajtjes: 21 – 25 Nëntor, 2024

Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtërueshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE), në partneritet dhe me financim nga “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH”, zyra në Prishtinë, organizon shkollën me temën **“Ndryshimet klimatike dhe tranzicioni i energjisë”**. Andaj, ftohen kandidatët e interesuar nga e tërë Kosova, që të marrin pjesë në këtë shkollë. Programi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe do të zbatohet nga AKEREE duke angazhuar ekspertë me përvojë në fushën e energjisë, përkatësisht në ndryshimet klimatike, tranzicionin e energjisë, eficiencën e energjisë (EE), burimeve të ripërtërueshme të energjisë (BRE), mjedisit jetësor dhe biodiversitetit.

Qeveria Gjermane, përmes GIZ Kosova, ka mbështetur shkollën verore që nga themelimi i saj, duke kontribuar vazhdimisht në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore. Gjithashtu, edhe në këtë edicion, GIZ vazhdon të ofrojë mbështetje të rëndësishme, duke siguruar që shkolla verore të jetë një platformë e fortë për edukimin dhe promovimin e tranzicionit energjetik dhe luftës kundër ndryshimeve klimatike.

Çështja e ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit të energjisë është një nga sfidat më të ngutshme globale të kohës sonë. Kjo i referohet nevojës urgjente për të kaluar nga një ekonomi me karbon, e cila kryesisht mbështetet në lëndët djegëse fosile (të tilla si qymyri, nafta dhe gazi natyror), në një sistem të qëndrueshëm energjie me pak karbon të bazuar në burime të ripërtërueshme të energjisë. Andaj në këtë drejtim, programi i shkollës ofron mundësi të mirë për të marrë njohuri në fushën e ndryshimeve klimatike dhe tranzicionin e energjisë, që përfshinë eficiencën e energjisë (EE) dhe burimet e ripërtërueshme të energjisë (BRE), mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetin, planifikimin e qëndrueshëm zhvillimor, etj. Programi është i përpiluar për studentët që planifikojnë të merren me fushën e energjisë, mbrojtjen e mjedisit si dhe burimeve të ripërtërueshme të energjisë – Lider të së ardhmes. Ky program do të jetë një mundësi e mirë për studentët që të zhvillojnë njohuritë e tyre dhe të rritin bashkëpunimin duke krijuar ura komunikimi në mes profesioneve të ndryshme, gjithnjë duke e konsideruar zhvillimin me emetime të ulëta të CO₂, secili nga aspekti i profesionit të tij.

Ideja kryesore e projektit të kësaj shkolle është për të krijuar një hapësirë të lirë edukimi, në të cilën studentët do të marrin njohuri dhe në mënyrë aktive mund të shkëmbejnë informatat dhe përvojat që lidhen me ndryshimet klimatike, EE, BRE, etj.



Kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në këtë shkollë duhet:

- Të jenë studentë në vitin e fundit të studimeve në nivelin bachelor ose të jenë duke vijuar studimet master në shkencat teknike, arkitekturë, ekonomi, menaxhment, shkenca të natyrës, ekologji/mjedis, agrokulturë, pylltari, shkenca politike, juridik, dhe të ngjashme.
- Të kenë njohuri në programet kompjuterike Microsoft Office si Word, Excel dhe Power Point. Gjithashtu duhet të ketë edhe njohuri për punën me internet.

“Shkolla për ndryshime klimatike dhe tranzicionin e energjisë” do të zgjasë pesë ditë. Do të ketë ligjërata dhe diskutime të cilat e përbëjnë pjesën teorike dhe do të mbahen përgjatë sesioneve të paradites. Po ashtu, do të jetë edhe pjesa e punës në grupe e cila do të organizohet përgjatë sesioneve të pasdites.

Grupet punuese do të trajtojnë nga një temë e cila do të i ‘u përcaktohet studentëve pjesëmarrës paraprakisht në ditën e parë të shkollës. Tema përkatëse do të trajtohet nga grupet punuese përgjatë pesë ditëve të shkollës verore. Në kuadër të kësaj ngjarje pesë ditore, një ditë do të organizohet vizitë studimore në një central për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE. Në përfundim të shkollës do të shpërndahen certifikata e pjesëmarrjes.

Për të aplikuar, kandidatët ose kandidatet e interesuar/a për pjesëmarrje në **“Shkollën për ndryshime klimatike dhe tranzicionin e energjisë”** duhet të dërgojnë:

- CV-në e tyre,
- Kopjen e letërnjoftimit,
- ID kartelën e studentit, dhe
- një letër motivuese e cila do të tregojë njohuritë në fushën e energjisë, mjedisit jetësor si dhe motivin e tyre për pjesëmarrje në këtë shkollë.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar.

Në rast të aplikimit të kandidatëve/kandidateve me kualitete të barabarta, përparësi do të kenë ata/ato që kanë aplikuar më herët në kohë.

Pjesëmarrësit nga vitet e kaluara të Shkollës Verore të organizuar nga AKEREE, nuk mund të marrin pjesë këtë vit.

Kjo është një mundësi e barabartë për të gjithë, mirëpo inkurajohet aplikimi i studentëve të gjinisë femërore.

Aktivitetet e shkollës mbahen në gjuhën shqipe, por njohja e Gjuhës Angleze është e preferueshme.

Koha e aplikimit është nga data **26 tetor deri me 12 nëntor 2024**, në fund të ditës kalendarike.

Dokumentacioni për aplikim të dërgohet në adresën elektronike: akeree@gmail.com

Për kandidatët/et e pranuar, shpenzimet për qëndrimin në hotel, ushqimi dhe vijimi i shkollës janë të mbuluara nga “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH”, zyra në Prishtinë, ndërsa është i siguruar edhe transporti pa pagesë për pjesëmarrësit, në relacionin: Prishtinë – Pejë – Hotel “Magra Austria”-Bogë, dhe kthimi i pjesëmarrësve pas mbarimit të shkollës. Varësisht prej cilit rajon do të jenë studentët e pranuar, ata me shpenzimet e veta duhet të udhëtojnë deri në Prishtinë, apo Pejë. Për këtë qëllim është i siguruar një autobus që do t’i merr studentët së pari në Prishtinë, pastaj në Pejë dhe për të arritur në hotelin “Magra Austria”-Bogë, ku do të bëhet organizimi i shkollës.

Për çfarëdo informacioni shtesë mund të kontaktoni në numrin e tel. + 383 44 413 241, çdo ditë pune prej orës 17:00 deri në ora 21:00, apo në adresën elektronike: akeree@gmail.com